



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1038/ 8 prot.,

Datë 07.05.2025

V E N D I M

Nr. 630/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.05.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “A.K.M” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-40401-03-06-2025, me objekt: “Shpim pusi në Libofshë për nevojat e shoqërisë” me fond limit 3,550,000.00lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “ALGEN-AL” SHPK me NIPT M24617401T dhe adresë: Karbunare e poshtme , NR pasurie 656/36, zona kadastrale nr 2087 Lushnje, perfaqesues i operatorit ekonomik “Mikael-Grup” SHPK me

Nipt K64108001G dhe adresë Lumalas, Perballe Fushes së Aviacionit nr/pas 39/79 ZK 2521, Korçë.

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A.
Lagja " 18 Tetori " Lushnje"

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik "A.K.M" SHPK me NIPT L22301501A dhe adresë: Rrashbull, Arapaj, Durrës.

Operatori ekonomik "Nika" SHPK me NIPT J76705047U dhe adresë: Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie, Shkodër.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi ankesën e ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik nuk ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.03.2025 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-40401-03-06-2025, me objekt: “Shpim pusi në Libofshë për nevojat e shoqërisë” me fond limit 3,550,000.00lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A.

II.2. Në datë 25.03.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 01.04.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “A.K.M.” SHPK	2 848 300 lekë	Kualifikuar
2. “Nika” SHPK	3 100 000 lekë	Kualifikuar
3. “MIKAEL-GRUP” SHPK	3 450 000 lekë	Kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 14.04.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 21.04.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5259, si dhe nr.1038/2025 prot, datë 22.04.2025 i operatorit ekonomik “ALGEN-AL” SHPK, përfaqësues i operatorit ekonomik “Mikael-Grup” SHPK, i cili lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “A.K.M” SHPK dhe “Nika” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1038/1, datë 23.04.2025, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues.

II.7. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 23.04.2025 është administruar shkresa nr.199/14 prot., datë 23.04.2025, protokolluar me tonën me nr 1038/2 prot., me objekt “Mbi plotësimin e të metave të ankesës” e autoritetit kontraktor, nëpërmjet së cilës njofton operatorin ekonomik ankimues për plotësimin e të metave të ankesës, që në rastin konkret kanë të bëjnë me kryerjen e pagesës për ankimin e paraqitur.

II.8. Informacionin e sipërpërmendur, shkresën nr.199/14 prot., datë 23.04.2025, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar, informacioni i cili është protokolluar me tonën me nr.1038/3 prot., datë 25.04.2025.

II.9. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr.468/3 prot., datë 25.04.2025, protokolluar me tonën me nr.1038/4 prot., datë 28.04.2025, me objekt “Vendim për shqyrtim ankese” autoriteti kontraktor ka përcjellë vendimin e komisionit për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se e ka pranuar pjesërisht atë.

II.10. Vendimin e komisionit të shqyrtimit të ankesave nr.468/3 prot., datë 25.04.2025, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar, informacioni i cili është protokolluar me tonën me nr.1038/5 prot., datë 29.04.2025.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuar, në përputhje me nenin 113, të ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të dosjes si edhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1 Komisioni i Prokurimit Publik, para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “ALGEN-AL” SHPK, përfaqësues i operatorit ekonomik “Mikael-Grup”

SHPK, konstaton se anikmuesi nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë pranë Komisionit të prokurimit Publik.

III.1.1. Në datën 07.03.2025 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-40401-03-06-2025, me objekt: “Shpim pusi në Libofshë për nevojat e shoqërisë” me fond limit 3,550,000.00lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A.

III.1.2. Në datë 25.03.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Në datën 01.04.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “A.K.M.” SHPK	2 848 300 lekë	Kualifikuar
2. “Nika” SHPK	3 100 000 lekë	Kualifikuar
3. “MIKAEL-GRUP” SHPK	3 450 000 lekë	Kualifikuar

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 14.04.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.5. Në datën 21.04.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5259, si dhe nr.1038/2025 prot, datë 22.04.2025 i operatorit ekonomik “ALGEN-AL” SHPK, përfaqësues i operatorit ekonomik “Mikael-Grup” SHPK, i cili lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “A.K.M.” SHPK dhe “Nika” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III.1.6. Neni 14, “Operatorët ekonomikë” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i dërguesit operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.
3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Ndërsa Neni 24, pika 1, “Komisioni i Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.1.7. Neni 88, pika 1 dhe 2 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” i VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cililën parashikon shprehimisht :

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

III.1.8. Paragrafi i parë i nenit 64 “Kuptimi i përfaqësimit” i Kodit Civil parashikon :

Me përfaqësim një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagrave që i janë dhënë nga ligji, prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar).

III.1.9. Neni 51 i Vendimit Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikon shprehimisht se: Komisioni zhvillon mbledhjen për shqyrtimin paraprak të ankesës nga ana formale, në të cilën verifikon:

a. juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;

b. legjitimitetin e ankuesit;

c. respektimin e afateve ligjore për ankimin;

d. elementet e domosdoshme të ankesës të parashikuara në pikën 2 të nenit 48 të kësaj rregullorej

III.1.10. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, ankesa është depozituar në sistemin e ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autritetit kontraktor nga operatori ekonomik “ALGEN-AL”SHPK me Nipt M24617401T, nëpërmjet llogarisë së tij nga e-Albania. Gjithashtu KPP konstaton se pagesa e tarifës së ankesës është kryer nga operatori ekonomik “ALGEN-AL”SHPK, sipas njoftimit (konfermës bankre) datë 23.04.2025 për faturën nr

//2025/5259 datë 21.04.2025, lëshuar nga KPP. Operatori ekonomik ankimues “ALGEN-AL” SHPK nuk është pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi, por përfaqësues i operatorit ekonomik “Mikael-Grup” SHPK, sipas autorizimit të datës 18.04.2025 lëshuar nga administratori i shoqërisë “Mikael-Grup” SHPK, pra operatori ekonomik ankimues shfaqet në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik “Mikael-Grup” SHPK.

Paragrafi i parë i nenit 64 “*Kuptimi i përfaqësimit*” të K.Civil parashikon shprehimisht se: “*Me përfaqësim një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagrave që i janë dhënë nga ligji, prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose kuridiktjetër (i përfaqësuar)*”. Referuar kësaj dispozite, Komisioni gjykon se, operatori ekonomik ankimues “Algen AL” SHPK nuk ka tagrin për të kryer veprime juridike, ankesë në rastin konkret, për llogari të operatorit ekonomik “Mikael-Grup” SHPK, pasi referuar dokumentacionit të ndodhur në dosjen e shqyrtimit administrativ, kjo e drejte nuk i është dhënë as nga ligji, as me prokurë dhe as nga gjykata, por nëpërmjet një autorizimi të thjeshtë të datës 18.04.2025 lëshuar nga administratori i shoqërisë pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit objekt ankimi. “Mikael-Grup” SHPK. Gjithashtu, referuar akteve të ndodhura në dosjen e shqyrtimit administrative nuk rezultojnë asnjë indici nga ky operator ekonomik, për pamundësi në dorëzimin e ankesës nëpërmjet llogarisë së tij nga e-Albania në sistemin e ankesave elektronike. Për më tepër, mënyra e delegimit të të drejtës së përfaqësimit nuk është ajo e përcaktuar në nenin 64 të K.Civil. Akoma më tej, nga verifikimi i Ekstraktit historik të regjistratit për të dhënat e subjektit “Algen AL” SHPK, të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezultojnë, se ky subjekt nuk ka të përfshirë në objektin e aktivitetit të tij shërbime përfaqësimi, ligjore, avokatie etj.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se operatori ekonomik ankimues nuk ka interes, si dhe nuk është dëmtuar nga vendimi i autoritetit kontraktor pasi ai nuk ka shfaqur interes, nuk është pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Neni 14, pika 2 “*Operatorët ekonomikë*” i Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 2. *Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i detyrues operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të*

kontratës, ndërsa Neni 88, pika 1 dhe 2 “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” i VKM nr. 285/2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, parashikon rregullat për mënyrën e paraqitjes së ofertës nga bashkim operatorësh ekonomikë. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës.

Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues nuk shfaqet në cilësinë e përfaqësuesit për bashkim operatorësh ekonomikë, çka do të legjitimonte ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Një operator që nuk ka marrë pjesë në procedurë, nuk ka paraqitur ofertë dhe nuk ka shprehur interes zyrtarisht për kontratën, nuk mund të pretendojë cenim të drejtave apo interesave sepse ai nuk ka qenë pjesë e procesit. Parimi i interesit të ligjshëm është thelbësor në të drejtën administrative dhe veçanërisht në sistemin e prokurimit publik. Një subjekt nuk mund të kërkojë rishikim të një procesi ku ai vetë nuk ka marrë pjesë, pasi mungon lidhja e drejtpërdrejtë midis tij dhe vendimit të kundërshtuar. Lejimi i ankesave nga subjekte të jashtme do të cenonte sigurinë juridike dhe do të zgjaste në mënyrë të panevojshme procesin e prokurimit, duke krijuar vonesa artificiale dhe pasiguri për autoritetet kontraktore dhe për operatorët që realisht kanë investuar kohë dhe resurse për të marrë pjesë. Sistemi i ankimimit është krijuar për të mbrojtur konkurrencën dhe barazinë ndërmjet operatorëve ekonomikë sipas nenit 109 të *lex specialis*.

Sa më sipër arsyetuar Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se:

Së pari ankesa është paraqitur nga një operator ekonomik i cili nuk është pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi

Së dyti operatori ekonomik nuk është pjesë e një bashkimi operatorësh ekonomikë me operatorin ekonomik “Mikael Group” SHPK,

Së treti, ankimuesi nuk ka tagrin për të kryer veprime juridike, sikurse është paraqitja e ankesës në rastin konkret, për llogari të operatorit ekonomik “Mikael Group” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi, pasi akti i përfaqësimit nuk është sipas formës së kërkuar ligjore,

Së kartërti ankimuesi nuk ka të përfshirë në objektin e aktivitetit të tij shërbime përfaqësimi, ligjore, avokatie etj.

Sa më sipër, Komisioni gjykon se nuk gjendet përballë asnjë rrethane që të mund të legjitimojë ankimuesin për paraqitjen e ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik dhe rrjedhimisht të investojë këtë të fundit për shqyrtimin administrativ të ankesës. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet për paraqitjen e ankesës në Komisionin e Prokurimit Publik e rrjedhimisht pretendimet e tij nuk merren në shqyrtim nga KPP.

Sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Algen AL” SHPK nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Algen AL” SHPK, për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-40401-03-06-2025, me objekt: “Shpim pusi në Libofshë për nevojat e shoqërisë” me fond limit 3,550,000.00lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lushnje SH.A.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryej veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Algen AL” SHPK,
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

